


Tregtia e jashtme e mallrave

Gusht 2018

Tiranë, më 17 Shtator 2018: Në Gusht 2018 eksportet e mallrave arritën vlerën 20 mld lekë, duke u rritur me 10,4 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe janë ulur me 23,9 %, në krahasim me Korrik 2018. Importet e mallrave arritën vlerën 48 mld lekë, duke u ulur me 2,6 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 17,3 %, në krahasim me Korrik 2018. Deficiti tregtar i këtij muaji është 28 mld lekë, duke u ulur me 10,3 %, krahasuar me Gusht 2017 dhe me 11,7 %, në krahasim me Korrik 2018.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në tetëmujorin e vitit 2018 eksportet e mallrave arritën vlerën 205 mld lekë, duke u rritur me 16,1 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 416 mld lekë, duke u rritur me 4,0 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 211 mld lekë, duke u ulur me 5,6 %, krahasuar me vitin 2017.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Rritja vjetore e eksporteve, prej 10,4 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +2,1 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +11,1 pikë përqindje, “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me +1,2 pikë përqindje“. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar negativisht grupi: “Tekstile dhe këpucë” me -2,6 pikë përqindje.

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Gusht 2018




Eksportet, gjatë këtij tetëmujori, janë rritur me 16,1 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +6,0 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +4,2 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +2,9 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar negativisht grupi: “Lëkurë dhe artikujt prej tyre” me -0,03 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Rënia vjetore e importeve, prej 2,6 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -3,7 pikë përqindje, “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me -0,9 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me -0,4 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar pozitivisht grupi: “Prodhime druri dhe letre” me +0,9 pikë përqindje.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Gusht 2018



Në këtë tetëmujor importet janë rritur me 4,0 %, krahasuar me tetëmujorin 2017. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve janë: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me +1,7 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +1,2 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +0,3 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar negativisht grupi: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -0,1 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Gusht 2018, vendet me të cilat Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Gusht 2017, janë: Kosova (44,7 %), Spanja (29,7 %) dhe Gjermania (31,1 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-6,3 %), Maqedonia (-18,2 %) dhe SHBA-ja (-18,1 %).

Gjatë këtij tetëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (4,3 %), Kosova (21,8 %) dhe Spanja (65,3 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Kina (-30,5 %), Turqia (-6,1 %) dhe Ukraina (-53,0 %).

Në muajin Gusht 2018, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Gusht 2017, janë: Italia (0,3 %), Turqia (11,6 %) dhe Maqedonia (29,6 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Kina (-1,4 %), Greqia (-11,9 %) dhe Gjermania (-0,8 %).

Gjatë këtij tetëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (0,9 %), Greqia (1,5 %) dhe Turqia (3,8 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Gjermania (-2,0 %), Spanja (-4,3 %) dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (-3,6 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Gusht 2018



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 61,4 % të gjithë tregtisë. Në Gusht 2018, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 68,3 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 58,5 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (26,1 %), Gjermania (7,2 %), Greqia (7,0%) dhe Kina (6,8 %).

Shkëmbimet tregtare, për tetëmujorin 2018, me vendet e BE-së, zënë 66,5 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Gusht 2018, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 76,3 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 61,7 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (34,6 %), Greqia (6,9 %), Gjermania (6,8 %) dhe Kina (6,1 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vietet (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vietet (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2016	01 - 16	16	-7,8	35	-1,0	-18	47,0
	02 - 16	18	-4,4	42	7,6	-24	42,0
	03 - 16	19	-12,7	47	5,6	-28	41,2
	04 - 16	21	1,7	52	19,0	-31	40,7
	05 - 16	21	-14,8	52	16,7	-31	39,6
	06 - 16	23	-6,4	52	6,2	-29	43,5
	07 - 16	23	-0,2	50	-4,5	-28	44,9
	08 - 16	16	6,9	47	15,9	-30	35,3
	Janar - Gusht 16	157	-5,3	376	8,0	-219	41,6
2017	01 - 17	19	15,6	35	0,9	-16	53,8
	02 - 17	20	14,2	44	5,1	-24	45,7
	03 - 17	24	22,0	54	14,9	-30	43,8
	04 - 17	24	13,7	50	-3,9	-26	48,1
	05 - 17	24	18,2	56	7,4	-31	43,6
	06 - 17	23	-0,1	57	9,2	-34	39,7
	07 - 17	25	9,9	55	9,6	-30	45,1
	08 - 17	18	12,3	49	6,2	-31	37,4
	Janar - Gusht 17	177	12,9	400	6,3	-223	44,2
2018	01 - 18	24	24,5	45	27,5	-21	52,5
	02 - 18	24	18,8	46	4,4	-22	52,0
	03 - 18	27	14,6	55	2,5	-28	49,0
	04 - 18	27	11,3	53	5,2	-26	50,9
	05 - 18	30	24,3	57	2,1	-27	53,1
	06 - 18	27	18,1	54	-4,7	-27	49,2
	07 - 18	27	8,2	58	6,0	-31	46,0
	08 - 18	20	10,4	48	-2,6	-28	42,3
	Janar - Gusht 18	205	16,1	416	4,0	-211	49,3

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)

	Eksporte				Importe			
	Gusht 17	Gusht 18	Jan.- Gu. 2017	Jan.- Gu.2018	Gusht 17	Gusht 18	Jan.- Gu. 2017	Jan.- Gu.2018
Vendet e BE-së	12.945	13.916	135.369	156.638	26.986	28.139	248.855	256.507
Austri	134	120	1.067	1.127	507	515	4.081	4.448
Mbretëri e Bashkuar	74	75	311	612	373	463	3.438	3.836
Gjermani	786	1.031	7.242	9.199	3.962	3.929	33.443	32.788
Greqi	700	772	7.698	8.687	4.599	4.050	33.798	34.290
Itali	7.966	7.462	94.438	98.537	10.371	10.400	115.041	116.111
Spanjë	1.439	1.867	9.497	15.703	1.321	971	9.269	8.875
Kroaci	64	75	524	579	331	582	2.973	4.516
Të tjera të BE-së	1.781	2.514	14.592	22.194	5.522	7.230	46.810	51.643
Kinë	724	355	5.610	3.897	4.383	4.324	31.042	33.704
Kosovë	1.967	2.846	13.837	16.850	799	808	5.324	5.592
Maqedonia	1.017	832	5.674	5.725	661	856	5.398	6.088
Rusi	29	11	77	29	2.153	1.454	7.296	9.359
SHBA	446	366	1.966	3.187	675	623	6.001	5.783
Turqi	195	280	1.469	1.379	3.701	4.130	32.670	33.903
Ukrainë	40	17	337	158	141	181	2.250	1.808
Zvicër	27	467	832	2.756	1.452	618	6.126	5.977
Të tjera	1.063	1.285	11.525	14.584	8.439	6.981	54.818	57.091
Gjithsej	18.454	20.375	176.697	205.204	49.391	48.115	399.781	415.813

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Gusht 17	Gusht 18	Jan.- Gu. 2017	Jan.- Gu.2018	Gusht 17	Gusht 18	Jan.- Gu. 2017	Jan.- Gu.2018
Gjithsej	18.454	20.375	176.697	205.204	49.391	48.115	399.781	415.813
Ushqime, pije, duhan	2.030	1.762	18.197	19.773	10.257	10.045	70.622	71.425
Minerale, lëndë djegëse, en.el.	3.332	5.377	29.313	39.943	7.365	5.523	37.191	42.007
Produkte kimike dhe plastike	466	444	3.140	3.682	6.446	6.793	57.468	58.247
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	130	119	1.961	1.916	918	804	12.428	12.482
Prodhome druri dhe letre	508	545	4.966	5.613	1.830	2.261	15.173	16.431
Tekstile dhe këpucë	7.180	6.704	76.992	82.110	4.838	4.808	55.119	56.388
Materiale ndërtimi dhe metale	3.346	3.737	28.046	35.538	5.643	5.680	51.285	51.015
Makineri, pajisje dhe pj. këmb.	891	1.104	9.194	11.140	10.371	9.940	84.712	91.334
Të tjera	573	586	4.887	5.489	1.724	2.262	15.783	16.484

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)

	Itali		Spanjë		Kosovë		Gjermani	
	2017	2018	2017	2018	2017	2018	2017	2018
Gjithsej	94.438	98.537	9.497	15.703	13.837	16.850	7.242	9.199
Ushqim, pije duhan	4.481	4.799	528	782	1.962	1.865	962	924
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	5.527	3.178	7.153	12.597	3.651	3.807	838	1.545
Produkte kimike dhe plastike	853	976	13	28	833	847	18	18
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.486	1.413	42	178	4	6	12	6
Prodhime druri dhe letre	3.477	3.889	3	286	264	290	69	99
Tekstile dhe këpucë	60.447	63.253	1.532	1.705	89	75	3.767	4.843
Materiale ndërtimi dhe metale	10.545	11.908	220	111	5.787	8.582	730	503
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	5.427	6.621	1	5	444	502	673	884
Të tjera	2.195	2.499	5	10	804	874	174	378

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)

	Itali		Greqi		Turqi		Kinë	
	2017	2018	2017	2018	2017	2018	2017	2018
Gjithsej	115.041	116.111	33.798	34.290	32.670	33.903	31.042	33.704
Ushqim, pije duhan	12.086	11.839	9.290	10.411	3.911	3.846	409	443
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	10.073	9.139	5.546	5.215	1.259	537	6	6
Produkte kimike dhe plastike	12.153	12.148	5.305	5.129	4.890	5.552	3.331	3.233
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	9.602	9.535	48	45	236	205	502	508
Prodhime druri dhe letre	4.134	4.831	2.134	2.249	2.234	2.180	736	751
Tekstile dhe këpucë	27.830	27.986	2.539	2.399	9.889	10.246	6.824	6.499
Materiale ndërtimi dhe metale	12.968	13.765	6.139	5.675	3.943	4.613	4.042	4.562
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	22.088	22.853	1.640	1.908	4.754	5.062	11.787	14.483
Të tjera	4.107	4.014	1.158	1.260	1.554	1.662	3.405	3.220

Përkufizime

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të rieksportuar, pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vijnë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes, nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Mbretëri e Bashkuar, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri